



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_351_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_V_544_01_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_544_01_11**;
6. Apeli i KEK-ut me datë 23.02.2011;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apeli i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Rexhep Susuri (shifra e konsumatorit DPZ – 42207) nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 22.04.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 20.02.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 07.07.2003 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik me nr. 5257064 vulat (bllobat) shtetërore i mungojnë dhe se duhet të bëhet ndërrimi njehsorit elektrik.
Provë: Procesverbali i KEK-ut, i datës 07.07.2003
- Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori posedon njehsor tre fazor Iskra në gjendje të parregullt dhe se njehsori është pa vula (bllobat) shtetërore dhe gjendja e numërorit është e dëmtuar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 038352 (mungon data e përpilimit të procesverbalit)
- Me datë 16.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 5257064 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 1748623.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik datë 16.06.2008
- Me datë 06.10.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 5257064 ku është konstatuar se njehsori elektrik nuk posedon vulat



(bllombat) shtetërore, nga ana e jashtme pjesa kyçese është e djegur, numëruesi i njehsorit është i manipuluar dhe i bllokuar ne tarifën e parë ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 18/3 i datës 03.10.2008

- Me datë 27.10.2008 punëtorët e autorizuar për shqyrtim njehsori kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 5257064 dhe kanë konstatuar se njehsori është brenda kufijve matës.

Provë: Protokoll mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 002906, i datës 27.10.2008

- Me datë 23.01.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04017 në vlerë prej 2,662.85 €.

Provë: Fatura DPZ08HP04017 e datës 23.01.2008

- Me datë 01.12.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK, datë 01.12.2008

- Me datë 20.02.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 20.02.2010

- Me datë 22.04.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së, datë 22.04.2010

- Me datë 10.01.2011 DMK ka lëshuar vendimin nr. **ZRRE/DMK_V_544_01_11** dhe në bazë të analizave të bëra, ka **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe ka arritur në përfundim se:

1. KEK-u duhet ta shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPZ08HP04017 të datës 23.01.2008 në vlerë prej 2,662.85 €.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_544_01_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK **ZRRE/DMK_V_544_01_11** të mbetet në fuqi.



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar